

Workshop-i Block I i programit të trajnimit për auditimet e performancës në kuadër të programit rajonal për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, organizuar në Shkup më 6-10 mars 2023

Në kuadër të programit rajonal për auditimet e performancës për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, u zhvillua në datat 6-10 mars 2023 në Shkup, workshop-i Block I i programit të trajnimit i organizuar nga SAI i Suedisë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua nga znj. Blerta Hima, audituese në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit, z. Jon Kraja, auditues në Departamentin e Auditimit të Institucioneve Qendore dhe z. Salvi Deda auditues në Departamentin e Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.



Përgjatë ditëve të zhvillimit, në workshop u trajtuan diferencat midis auditimit financiar, auditimit të përputhshmërisë dhe auditimit të performancës, si dhe u prezantua procesi i auditimit të performancës të SAI-it Suedez dhe Norvegjez, pasuar nga SAI-t pjesëmarrëse.

Një tjetër aspekt i programit ishte prezantimi i konceptit të 3E-ve (Ekonomi, Efikasitet, Efektivitet), modeli "Hyrje-Dalje" (Input-Output) dhe një hyrje në konceptin e "Pema e Problemeve" (Problem Tree) dhe në analizimin e problematikave (Problem Analysis), ku pas prezantimit, pjesëmarrësit u ndanë në grupe për të diskutuar dhe për të analizuar problematikat e evidentuara në praktikën e caktuar për secilin grup.

Në përmbyllje, u prezantua faza e para-studimit në auditimin e performancës, ku u trajtua objektivi i auditimit, fushëveprimi i auditimit, pyetja audituese dhe kriteret e auditimit, si dhe një hyrje në metodat e mbledhjes së të dhënave. Prezantimi u pasua me ndarjen në grupe, përcaktimin e praktikës që grupet duhet të analizojnë dhe prezantimin nga të gjithë pjesëmarrësit.